



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 4046 prot

Vlorë, më 28/12 /2018

VENDIM

Nr 48 datë 20 / 12 /2018

Për miratimin e programit të transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datën e sipërpërmendur, në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 dt.17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1.1 gërma a dhe b, neni 77 gërma k dhe Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit " nenet 4, 6, 7 dhe 8, Ligjit nr. 8517 date 22.07.1999 " Për mbrojtjen e te dhënave personale ,, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013" Për nënpunesin civil " i ndryshuar, Ligjit nr. 9131 date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" si dhe urdhërit nr. 211 date 10.09.2018 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore "

Vendosi :

- 1) Miratimin e programit të transparencës sipas formatit të ri standart, bashkëlidhur këtij vendimi, të dërguar nga Komisioneri për të drejtën e informimit.
- 2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 dt.17.12.2015 "Per vetëqeverisjen vendore" neni 78 pika 3.

Konc.

Klaud Gjipali
Këshilltar për çështjet ligjore

Olvi Merkaj
Drejtor i Kabinetit

Margarita Binaj
Specialiste e Prot.-Ark. dhe BNJ



ERVIS MOKKA
KRYETAR

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën me nr. _____ prot. Dt. ____/____/____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Këshilli i Qarkut Vlorë me vendimin nr. 38 dt. 20.12.2017 "*Për miratimin e rishikimit të programit të transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë*" ka miratuar si detyrim ligjor programin e transparencës për vitin 2017. Nëpërmjet programit të transparencës Këshilli i Qarkut vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato. Për të arritur një nivel transparence standarte në të gjitha organet e qeverisjes vendore, Komisioneri për të Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet urdhërit nr.211 datë 10.09.2018 ka kërkuar miratimin e **programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas programit standart të dërguar prej tij**. Për këtë arsye lind e nevojshme miratimi i një formati të ri nga ana e Këshillit të qarkut Vlorë i cili duhet të zbatohet si një detyrim ligjor nga data 1 janar 2019 e në vazhdim.

Nisur nga sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 dt.17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1.1 germa a dhe b, neni 77 germa k dhe Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit "nenet 4, 6, 7 dhe 8, Ligjit nr. 8517 datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale ,, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 "Për nënpunësin civil " i ndryshuar, Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" si dhe urdhërit nr. 211 datë 10.09.2018 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore " Këshilli i Qarkut Vlorë ka pregatitur materialin dhe ua vendos në dispozicion sot për ta miratuar në Këshill.

Ju Faleminderit.

Grupi i Punës